
VALLJA MBI VALLE DHE SHTRIRJA E SAJ TE POPUJT SLLAVË TË BALLKANIT DANCE OVER DANCE AND ITS COVERAGE OF THE SLAVIC PEOPLES OF THE BALKANS

ISMAIL DODA
Ulqin, MONTENEGRO
E-mail: knshzmz@hotmail.com

AKTET VI, 5: 510 - 516, 2013

PËRMBLEDHJE

Artikulli shtron në diskutim vallen Vallja mbi valle që luhet nga shqiptarët e Malit të Zi dhe nga malaziasit e dalmatët. Shtrirja e lëndës dhe interpretimi i saj sheshtohet në kontekst ra-jo-nal (krahinor) e të përgjithshëm kombëtar, në njërën anë; dhe ndërkombëtar malazias e dal-mat, në anën tjetër. Substanca prijatë shqiptare e saj argumentohet me zgjerimin e motivit (bre-nda krahinës) dhe me shtrirjen gjeografike në gjithë territorin kombëtar e te arbë-re-shët e Ita-lisë, që dëshmon traditën mbarëkombëtare shqiptare dhe lashtësinë përtej mesjetare të mo-ti-vit. Vallja mbi valle (Krajë e Shestan) konsiderohet si arketip i tri valleve të tjera të kësaj kra-hine: Vallja krajane, Oj Rumije, bjeshkë e naltë (Shestan), Këndon Bega zanë në mal (Reç, Ul-qin). Me sheshtimin e motivit ndër dalmatë e malazias dëshmohet shtrirja e tij në rrafsh ndër-kombëtar. Analiza duke dëshmuar njësinë e përbashkët kombëtare shqiptare mëton të argu-mentojë tezën e shtegtimit të këtij motivi nga shqiptarët te këta popuj të Ballkanit Pe-rë-n-di-mor. Artikulli sjell ndihmesë në teorinë e huazimit. Argumenti, përveç tjerash mbështetet edhe në lidhjet e ngushta që ka ky motiv me artin e vallëzimitit e të koreografisë, me çka në aspektin teorik argumentohet jetesa sinkretike e formave të ndryshme të folklorit.

Fjalët çelës: valle, baladë, motiv, interpretim, koreografi, sinkretizëm, folklor.

Key words: dance, ballad, motivation, interpretation, choreography, syncretism, folklore.

Hyrje

Baladat: “Ulu mal të dal-e hana”, “Kam një vlla të tretun-o”; “Vriten e priten dy male”; “Ishnjn dy motra pa vlla”; “Në Qafa të Shkodarasë”; “U zu djali rrog me’i vashë”; “Mrikalem, shoqeja jonë”; “Larg ma luhdonjin një vashë” (Çeta 1974: 130-135; 272-277) në Ljare: “Motra me nand vllazen”; “Ishin dy vllazëni” (Dorëshkrim Ismail Doda) këndohen dhe luhen në valle në krahinat shqiptare ndërmjet liqenit të Shkodrës dhe detit Adriatik, në Malin e Zi.

Në Anë të Malit vallnisht (në valle) këndohen edhe: “Shiti tokë e kallamaq”, “I ra mjegulla Bunjarit”, “Ali Begu pa ban darsëm” (Doda I, 1984: 1-3; 23-26; 37-38). Baladën “Aga Imeri”, e këndonin gratë në valle në Bobosht (Krajë, Duraku 1979). Motërzimi “Ymer aga u martuo”

është luajtur dhe kënduar në valle më 1959 dhe 1960 në fshatin Gurrz të Shestanit Sipërm (Dabaj 2004: 225-226, 675).

Lashtësia kombëtare shqiptare e motivit dhe lidhjet e tij me llojet e tjera folklorike në Krajë, me gjithë Shestanin dëshmohet me luajtjen në valle të tri baladave shumë të lashta gjithëshqiptare: (a) baladën e murimit: “I ra mjegulla Buenas-e”; (b) baladën e besës së dhënë: “Aga Imeri”; dhe (c) “Ditën e pashkës së madhe Dhoqina na hidhej valle” (Mokër, Pogradec). Këto dëshmojnë për një shtresë kombëtare të paktën që në Mesjetë (Bogdani 1987: 157, 158, 159, 160).

1. "Vallja mbi valle"

Të dhënat për këtë valle të luajtur në Shestan i regjistron nga Preç Maci Vukmarkaj (Vukmarkaj 1881 – 1983) më 30. 12. 1979 në Zalef (Tivar). Meqë kanë edhe peshë dialektologjike e historike, ato do t'i jap në të folmen e tij shestanase: "Na kena luojt: 1. "Valle përmi valle"; 2. "Valle rrotull". E kô filluo këngën njani e e kanë knuo t'gjithë bashkë. Njerë kta (poshtë), njerë ata (nalt). T'partë tonë çë (qysh) moti kanë luojt. E kanë suo pej t'moçemve. Ashtu mâ shkon brez mas brezi. Unë s'kam luojt "valle përmi valle". I vocël (vocërr, I. D.) ishesh, po mô men kur luonte vallja. Deri vonë kanë luojt "valle mi valle". Kena knuo këngë t'bukura shqip. Mâ vonë u harruo ajo punë". Me këtë rast m'i recitoi baladat: "*Hoj Rumija bjeshkë e naltë*"; "*Hoq shpatë, i prev të të shtatë*"; "*I ra mjeglla Bujenës*". Sigurisht se edhe këto janë kënduar në "vallen mbi valle" (shënimi im- I.D.)

Mbi sa u tha dëshmohet se këto ishin dy valle të kënduara që luheshin bashkë:

1. *ajo poshtë*, të cilën informatori e quan "*Valle rrotull*", emërtim ky i qëlluar që është zhdukur me kapërcimin e kohës;
2. "*Vallja mbi të, në kat*" është: "*Vallja përmbi valle*", që Dabaj e quan edhe "*Valle kështjellë*" (Dabaj 2004: 508, 509).

"*Vallja mbi valle*" është luajtur edhe në Krajë të Madhe, përkatësisht në Krajën Poshtë, pra, në Krajë me kuptimin e ngushtë të fjalës, deri aty nga fillimi i shek. XX³⁶. Ajo ka ngjasi me vallen që luhet tash në Cermnicë dhe trevat e tjera sllave. Te këta të fundit quhet "*kolo na kolo*" (valle mbi valle, I.D.) (Shoç 1984: 36). Në Cermnicë, ku është ruajtur më fort, s'ka emër tjetër përveç "*Crmoniçko kolo*" (vallja e Cërmoniçës, I.D.) (Rovinski 1998: 504).

Olivera Mladenoviç "*Vallen mbi valle*" e quan "*Kolo na kolo*" ose "*kolo na kat*". Ajo pohon se vallja i përket traditës së lashtë, madje jo vetëm të popujve ballkanikë (Mladenoviç 1974: 377, 381, 384).

Në rrafshin Ballkanik dëshmohet se deri vonë është luajtur në krejt Hercegovinën Lindore. Për më tepër, në Gacko dhe në Mal të Zi e në Sanxhak ortodoksët e myslimanët e kanë

identifikuar me këngën "*Oj, djevojko Stambolijo*" ("*Moj, ti vajza stambolleshë*", I.D.).

Mladenoviç vë në dukje se kjo valle baladeske konsiderohet si një dukuri e izoluar në Sllaveni, Bosnje, Sllavoni, Serbi, Maqedoninë Veriore, pjesën e Pirinit të Bullgarisë, bile edhe te popullsia me përbërje të ndryshme fetare (ortodokse, katolike e myslimane). Më tej konstaton se vallja e përmendur, në kohën kur e shkroi punimin (1967) luhej për Pashkë, për Shëngjergj dhe për Bajram. Meqë i mungonte literatura greke dhe shqiptare mbështeti opinionin e krijuar atëherë se kjo valle është dukuri sllave në Gadishullin Ballkanik, por duke shprehur dyshimin se gjurmë të saj duhet të ekzistojnë edhe te shqiptarët e grekët. Dhe kur këto të njihen, atëherë do të mund të flasim për një praktikë të lashtë ballkanike, ndoshta edhe për lidhjet e saj më të forta me Kaukazin.

Motërzimet e kësaj valleje në një numër të madh shqiptarësh, që, në Ballkan janë më të hershëm se sllavët e përjashtojnë çdo supozim se "*Vallja mbi valle*" na qenka përvetësuar prej tyre dhe se ajo na qenka një dukuri sllave. Zanafilla e saj nuk ka të bëjë as me ndikimin nga Kaukazi, çerdhen e hershme të sllavëve.

"*Vallja përmbi valle*" e Malësisë së Madhe e interpretuar në Festivalin Folklorik Kombëtar të Beratit më 1995 (Bogdani 1995: 124) e quajtur "*Valle mbi valle*" a "*Vallja kuille*" me dy grupe valltarësh të vendosur njëri mbi tjetrin, që luhet në zonat fshatare e fushore të malësive shqiptare të Mbishkodrës që pati ndikim të popujt fqinjë, sipas studuesve, për nga gjeneza shënon një kulturë të hershme indoevropiane, ndërsa si formë vallëzimi lidhet me kremtimet e pubertetit dhe shërbente si monument kalimi nga adoleshenca në maturitet (Haxhihasani 1992: 109).

2. Vallja krajane

Në krye të interpretimit të valleve popullore te shqiptarët në Malin e Zi qëndrojnë:

2.1. "*Vallja e Krajës*" e cila spikat në këto drejtime:

"*Vallja krajançe*" dëshmohet në 1977 në Shkodër. Është e përhapur në ritet e lashta të dasmës (apo të shtregullave) (Selimi 2003: 85). Holto Shupo

thekson se ruhen mjaft mirë tiparet e zonave fshatare përreth dhe se: “atdheu i tyre duhet të ketë qenë krahina e Krajës, Ljares e Shestanit, ku janë ruajtë në origjinalitetin e tyre. E jo vetëm janë ruejtë, por janë të daluna prej andej” (Shupo 2007: 207, 208).

“Vallja krajane” më 1970 është ekzekutuar në Rivistën V të Folklorit në Zagreb (Program 1975: 16). Është e njëjtë me atë të Shestanit: “Kena luojt valle Shestani” thonë fshatarët e fshatit Uzhdabiq (Doda 1980). Ka afri edhe me vallen që luhet në Anë të Malit. Të dyja këto valle u paraqiten me sukses në Festivalin Kombëtar – Berat (shtator 1995) (Bogdani 1995: 120, 121).

“Vallja e Krajës” është e pranishme edhe në rrethina të Ulqinit dhe të Tivarit, kryesisht midis popullatës së zbritur aty qysh herët. Tipare të përbashkëta, si nga përbërja, ashtu edhe nga përmbajtja ka me të edhe “vallja e Merkotit” (Mrko(je)vići), përgjithësisht sot trevë joshqiptare, me fe islame.

2.1. Mënyra e vallëzimit

Vallen e Krajës, me gjithë motërzimet e veta, veçanërisht në truallin shqiptar, e luanin burrat, ndaras nga gratë. Nga fillimi i pjesës së dytë të shek. XX, në rrafshin gjinor ajo u bë *valle e përzierë*, gjysmë rrethi nga burrat, gjysmë nga gratë. Si valle e rrethit të mbyllur është shumë e lashtë. Mendimi i R. Bogdanit për vallen e mbyllur të Malësisë së Madhe, vlen edhe për këtë të Krajës, sepse: “vallet në rreth të mbyllur jo vetëm që mbahen mend në kujtesën e të moshuarve”, por duke u praktikuar edhe sot dëshmojnë vazhdimësinë e kësaj tradite të lashtë (Bogdani 1998: 122).

Lashtësia e valles së Krajës vërtetohet edhe me lidhjen e saj me baladën e murosjes, e cila deri në fund të viteve '70 të shek. XX këndohej dhe luhej në të. Praktikohet në gazmende familjare në Shestan dhe tek të zbriturit në Tivar (Bajraktari 1978) dhe në Krythë të Ulqinit me titullin “*Na'j ka ra mjeglla Bujenës*” (Dabaj 2004: 514-515).

Prijësi në fillim merr emërvendin: “Buenas-e”, kap pjesën e parë të vargut: “Na i rô mjeglla”, duke shtuar edhe refrenin: „Buenas-e”. Në këtë mënyrë fundi dhe mbarimi i vargut bashkohen në

qarkullim kur kënga këndohet *shkurta-shkurt* dhe *me tempo të shpejtë*: “Buenas-e”, “Na i rô mjeglla Buenas-e”. Këtë e përsërit edhe pala e tij (e saj), duke ia marrë, pothuajse, fjalët nga goja. Në të njëjtën mënyrë ia pret këngëtari i palës tjetër me shokë. Kënga, në të vërtetë melodia i ka ruajtur të gjitha elementet, për dallim nga e folmja popullore ose ajo e tekstit, kur këngëtari e ka recituar:

Buenas-e

Na'j rô mjeglla Buenas-e } 2 x

Valdanas-e

Buenas-e Valdanas-e } 2 x

(Doda 1984: 173).

2.2. Rrezatim te bota sllave

Duke i kaluar kufijtë krahinorë dhe kombëtarë “Vallja e Krajës”, përmes Shestanit qysh në lashtësi është përhapur edhe në Cërmnicën fqinje, krejtësisht sllave, ku njihet me emrin burimor “*Shestansko kolo*” (Vallja e Shestanit, I.D), por edhe me emërtime lokale sllave, si “*Crمنىčko kolo*” (Vallja e Cërmnicës, I.D) (Shoç 1984: 40).

Vërtetë, më tepër se asnjë valle tjetër malaziasë, ajo gjason me atë të Krajës, si nga praktika e luajtjes (nisjes nga e majta në të djathtë, lëvizja e hapave), ashtu edhe nga përcjellja me këngë. P. Rovinski mendon se elementi shqiptar në Cërmnicë është shumë i lashtë dhe i përket periudhës së Nemanjiqëve. Ai pranon se mbi elementin shqiptar janë ndërtuar elementi sllav dhe është shkrire krejtësisht në të (Rovinski 1998: 47).

Shqiptarët në këto anë përmenden në analet më të hershme për Cërmnicën që lidhen me shekullin XIII (Vujović 1933: 7). Prania e kësaj valleje në këtë krahinë, në një periudhë kaq të hershme është një dëshmi e rëndësishme historike, e cila krahas emërvendeve në gjuhën malaziasë provon (a) lashtësinë e saj paramesjetare dhe (b) dëshmon elementin prijatar dhënës të folklorit shqiptar.

3. Shtrirja e motivit në trollin kombëtar

3.1. Në Malësi të Madhe luhet në valle kënga “*Gur kaj' gur bohët kalaja*” (Bogdani 1995: 121).

Ramadan Sokoli më (1962) e përmend mënyrën e të kënduarit të gojëdhënës së murosjes nga kolonjarët dhe kolonjaret, ku gratë si në çdo zonë të polifonisë sonë popullore, nuk këndojnë njësoj si burrat (Sokoli 1965: 331).

Valltarët dhe valltaret e Krajës të kapur pas shpine për beli lidhen në formë rrethi, sillen nga e majta në të djathtë: tri gjurmë (nga gjysmë hapi) përpara e një mbrapa; shkojnë tri gjurmë apo gjysmë hapi, në të djathtë. Vallëtarët pa e ndalur lëvizjen kthehen në të majtë një gjysmë hapi. Me atë rast këmba e majtë ndeshet me të djathtën dhe përnjëherë prihet me këmbë të djathtë tre hapa përpara (Doda 1984: 174).

3.2. R. Sokoli vëren një afri të kësaj valleje me këngën lirike të Malësisë së Madhe, e cila në Krajë ka formën e baladës: *“Oj Rumi e bjeshk’e nalt-e”*. Dallimet dalin në rrafshin gjuhësor:

bjeshk’e nalt-e,

Moj Rumije bjeshk’e nalt-e

bjeshk’e nalt-e.

Përveç kësaj ai shton se dallime hasen edhe në zgjatjen e fjalëve, të cilave u shtohet “ndonji tingull a ndonjë rrokje në mbarim (paragogë)”. I referohet baladës krajaane me dy vargje: “I kalova t nandta male, / Në të dhetin dola n’ maje”. Këtë dukuri e vërenë edhe në baladën e *“Shtatë Hajdukëve”* po nga Kraja:

Trija vjeçe e fejoj

Gjashta vjeçe e martoi,

Ndandta vjeçe duel me barrë

(Sokoli 1965: 109, 81)

Në dhoma të mëdha, kur gazmendi zhvillohej në mbrëmje, pothuajse tërë natën luhej vetëm një valle me 20-30 e më shumë valltarë. Që t’i sajdisnin edhe të tjerët, ata ndërroheshin me radhë. Në mjedise të hapura ditën, po në atë gazmend silleshin dy e më tepër valle përnjëherësh, jo larg njëra-tjetrës, me më shumë valltarë.

Luhet sipas mundësive që ua krijon ai që e merr këngën. Kur vallja ekzekutohet me ritëm të ngadalhtë “laimçe”, siç i thonë në Krajë, shoqërohet nga melodia me zë të ulët. Ashtu vijon rreth një gjysmë ore. Mbasandej niset me ritëm të shpejtë “muriqisht” (i mbiquajtur sipas

mënyrës së luajtjes në fshatin Muriq të Krajës, I.D.) dhe me zë të lartë.

Në Shestan luhet *krushqisht* (Daboviç 2006: 342; Dabaj 2004: 635). Lidhet me vallen që hedhin me vrull krushqit para nisjes për nuse. Për shkak të lodhjes, pasi vallja zgjatë gati gjysmë ore, valltarët i shqiptojnë fjalët në formë të shkurtuar. Ndërrojnë hapin. Kur sillet ngadalë, s’i ngrejnë këmbët, kur shkon me shpejtësi, këtë e bëjnë me qëllim që të marrë gjallëri.

Për t’u shtuar hareja, nga ndonjë valltar dalin britma gëzimi: “I-ha-ha/ Ç’e ka e lumja”. Epiteti shtesë i formuar nga mbiemri cilësor e lumja dëshmon lashtësinë e kësaj valleje (Çabej 1976: 325).

4. Shtrirja ndër dalmatas

“Vallja e Krajës” me *“Hapin shqiptar”* ka arrirë të shtrihet në Novi Vinodolski në Dalmaci (Jezhiç 1979: 13).

Vallja dalmate luhet sipas taktit të cilin e japin “këngëtarët”, që këndojnë në mes të valles nga tre deri në katër çifte. Ajo fillon me fjalët: *“Hajt në valle kush është për valle”*. Njësoj si në Krajë: *“Kush vjen, vjen me xanë nji valle”*.

Në Vinadol, melodia në fillim këndohet me rit[m dhe hap të ngadalshëm. Rëndom zgjat një çerek ore, përderisa nuk plotësohet dhe rrethohet vallja. Ky tempo profesionalisht quhet “hapi senjas”. Është karakteristike se në vendet fqinje të Vinadolit e quajnë “hapi novlanas”.

Jezhiç i thekson se këngëtarët e vazhdojnë këngën me të shpejtë dhe përnjëherë qindra valltarë e valltare ndërrojnë hapin në të ashtuquajturin “hap shqiptar”. Përderisa me hapin senjas luhet ngadalë dhe nuk ngritet këmba e djathtë. Ngritja e këmbës së djathtë valles i jep ritëm më të shpejtë e më impulsiv.

Më pas “këngëtarët” fillojnë melodinë e re. Vallja luhet më shpejt, më hareshëm. Është hapi më i hareshëm i valles. Hapi i kërcimit është i ngjashëm me atë shqiptar. Autori vëren se valltarët e valltaret për një nuancë e ngrisin këmbën më lart dhe kështu ritmi i vallëzimit bëhet më i hareshëm. Nëse me atë rast kryesuesi i valles këndon diçka si p.sh.: *“iju, ju, ju...”*, valltarët e valltaret, sikurse edhe këngëtarët e

valles e imitojnë atë që kërcen. Kështu që edhe ky hap u quajt kërcyes (Jezhiç 1979: 13).

Sa i përket këtij hapi – shton Jezhiçi, nga momenti kur hyri në valle kryefamiljari Arbanasi (Arbëneshi) me 5 djemtë e tij (pa shënuar se nga cila krahinë shqiptare janë këta arbëreshë) solli risi, duke futur hapin shqiptar, si prurje e vendlindjes. Atëbotë, sikurse thotë tradita pëshpëritej: “Arbëneshët këndojnë hareshëm, edhe ne të vazhdojmë si arbëreshët”.

Ky hap që nga kohët e lashta, kah mbarimi i shek. XV merr emrin “hapi shqiptar” (arbëresh). Por duket se bëhet fjalë pikërisht për familjen Arbëneshë, e cila në Vinadol duhet të ketë ardhur përgjatë kohës së princ Martin Frankopanit (Jezhiç 1979: 13).

Edhe në këtë valle, si në shembullin e asaj të Krajës shprehet gëzimi nga brenda. Në të parën, gëzimi përmbushet nëpërmjet epitetit të formuar prej mbiemrit cilësor: “*e lumja*” i thënë prej ndonjë valltari të papërcaktuar.

Tek ajo e Dalmacisë përmbushet me anë të pas-thirrme emocionuese: “*iju, ju, ju ...*” të cilën e thotë valltari i caktuar – heqësi i saj, por që është e kuptueshme vetëm nga arbëreshët e kohës.

Kjo afri kulturore (Krajë – Dalmaci) lidhet me rrënjët e përbashkëta të dy fiseve ilire – *la-beatëve* dhe *dalmatëve*. Sipas asaj që sjell Jezhiçi (1979) mësojmë se para 135 vjetësh banori i Novlanës, gjuhëtari i njohur kroat Antun Mazhuraniqi kishte theksuar se vallja, ashtu siç luhet sot në Novi Vinodolski luhej dhe kultivohej në mbarë Bregdetin Kroat, posaçërisht në Senj, por edhe në Dalmaci, në Bokë të Kotorrit dhe në Malin e Zi. Kjo nënkuptohet edhe nga përshkrimi i valles novlanase prej Milutin Mazhuraniçit adhures i njohur i dokeve të atij vendi. Ai në vitin 1937, në “*Primorske novine*” dallon këtë valle nga vallja sllavonase, likase ose krainase. Në këto të fundit lozin njëzetë persona në përcjellje të gjadës ose këngëve të beqarëve.

Mazhuraniçi pohon se: “vallja novlanase është një harmonizim i personifikuar, i stolisur me veshjen e mrekullueshme dhe plot shije popullore kroate bregdetare, që janë shumë të lashta. Këto shprehen me hapin e gëzueshëm të

njëmijë këmbëve që shoqërohen nga këndimi i këngëve të lashta (Jezhiç 1979: 13).

Lorenc Antoni (më 18 tetor 1975) inçizoi në Ostros baladën “*Gjon Pretika*”, të interpretuar nga nxënës e mësimdhënës, të lindur mes viteve 1945-1962. Është e njëjta valle e mbyllur e Krajës, për të cilën folëm më sipër.

Grupi i meshkujve:

Këndon Bega zan’na mal-e }

.....mal-e }

(Antoni 1977: 139, 140, 143).

Këtë baladë, një vit më parë (më 1974) e këndoi dhe e ekzekutoi në valle grupi i këngëtarëve të fshatit Reç (Ulqin) në Rivistën IX të Folklorit në Zagreb (Program 17). Në Rivistën e III të këtij festivali (më 1968) grupi i Shestanit e këndoi në valle baladën “*Oj Rumija bjeshkë e naltë*”.

Përfundime

1. Interpretimi në valle i baladave popullore shqiptare në Malin e Zi kryesisht realizohet përmes valles së lashtë të mbyllur dhe të kënduar të Krajës, ndërsa deri në fillim të shek. XX edhe përmes “*Valles mbi valle*” si ndikim indoevropian, shumë më heret se të vinin sllavët në Ballkan. Me gjithë shtrirjen në krahinat fqinje shqiptare dhe përtej, tek ato sllave, me mjaft ngjashmëri edhe me “*Hapin shqiptar*” në Dalmaci që u bart në shekullin XV nga një familje e njohur atje me emrin Arbanasi (= Arbëneshi).

2. Sidomos çon peshë ekzekutimi i baladave të lashta: (a) *asaj të murimit* që lidhet me kësh-tjellën “*Rozafat*”; dhe (b) *e besës së dhënë* – “*Aga Ymeri*”. Ato së bashku edhe me dy motivet e para të arbëreshëve të Italisë janë luajtur në vallen me karakter baladik që lidhen me këngët “*Skënderbeku një menatë*”, “*Konstantini e Juredina*”, “*Pse s’ha bukë e s’pi verë more Ymer agë*”.

3. Brenda hapësirës në formë trekëndëshi: në skajin veriperëndimor shqiptar nga gegët; në atë jugor nga toskët dhe në atë përtej Adriatikut nga arbëreshët e Italisë, së paku qysh në Mesjetë, pasqyrohet një dukuri e lashtë mbarëkombëtare përmes baladave me karakter elegjik e dramatik të gërshetuara me elemente mitike e fantastike, që gjithnjë vazhdojnë të luhen në valle. Kjo për

shumë popuj sot është dukuri e rrallë dhe gati e paparë.

Ky element dëshmon katërçipërisht zanafillën e hershme të identitetit tonë kombëtar e kulturor. Sipas R. Bogdanit, i cili pas afër dy dekadave iu kthye kësaj dukurie të ruajtur në zonat e sipërpërmendura malore të Pogradecit, posaçërisht banorët e krishterë të fshatrave Podgozhan, Pleshisht, përbëjnë një bashkësi ku ka jetuar në mënyrë të gjallë deri në ditët tona balada e përcjellë me valle. Tri janë baladat më të njohura: “Balada e murimit”, “Ymer Agës”, apo e “Konstantinit të vogëlith” dhe ajo e “Konstantinit dhe Dhoqinës”. Në veçanti vihet në dukje fakti se këto tri balada përshkohen nga rite e zakone të lashta, ku gërshetohen gjurmë të karakterit elegjik e dramatik me elemente mitike e fantastike (Bogdani 2006: 110, 111).

Bibliografi:

- ANTONI, Lorenc (1977), *Folklori muzikor shqiptar* (Bleni VII). Rilindja, Prishtinë.
- BAJRAKTARI, Kolë (1978), Informatë gojore që ma dha në Fushë të Tivarit më 31. 12. 1978 Kolë Bajraktari, lindur në fshatin Dedanj më 1892, bujk, kreu dy klasë fillore në gjuhën serbe, i cili nga Shestani u shpërngul në Fushë të Tivarit më 1918 dhe jetoi deri më 22. 03. 1982, kur ndërroi jetë.
- BOGDANI, Ramazan (1987), Specifika e vallëzimit në baladat shqiptare: *Çështje të folklorit shqiptar* 3. AShSh. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë.
- BOGDANI, Ramazan (1995), Folk – vallja në Festivalin Kombëtar, Berat 1995: *Kultura popullore*, Tiranë, nr. 1, 2.
- BOGDANI, Ramazan (1998). Tradita e folklorit koreografik të Malësisë së Madhe: *Studime filologjike*, Tiranë, nr. 2.
- BOGDANI, Ramazan (2006), Rreth valleve të Toskërisë: *Kultura popullore*, Tiranë, nr. 1-2.
- ÇABEJ, Eqrem (1976), *Studime gjuhësore I*. Rilindja, Prishtinë.
- ÇETTA, Anton (Përgatitur) (1974), *Balada dhe legjenda*. IAP, Prishtinë.
- DABAJ, Gjakë (2004), *Shestani. Studim filologjik gjithëpërfshirës I*. Ulqin – Tivar – Prishtinë, k. nr.1.
- DODA, Ismail (1984), *Balada krajane e murosjes së gruas*. Punim magjistrature. UK, Fakulteti Filologjik, Prishtinë.
- DODA, Ismail (dorëshkrim), *Balada popullore nga Ana e Malit I*.
- DURAKU, Hava Taip (1979), Informatë gojore, dhënë në Arbnesht, më 18.03.1979 Hava Taip Duraku (01.06.1903-30. 10. 1997) nga Boboshti, e martuar Priftaj.
- HAXHIHASANI, Qemal (1992), Lidhjet midis folklorit qytetar dhe fshatar në trevën veriperëndimore të Shqipërisë: *Kultura popullore*, Tiranë, nr. 1, 2.
- JEZHIÇ, Davorin (1979), “Hapi shqiptar” në vallen kroate: *Fjala*, Prishtinë XII/19. Rrënjët e lashta të valles së Novi Vinodolskit provohen me faktin se ajo u luajt më 1288 kur u krijua Statuti i Vinodolskit, monumenti i parë juridik në Ballkan kur Novi ishte kryeqendër e Principatës së Vinodollit, vend i ngritur para më se 2000 viteve.
- MLADENOVIÇ, Olivera (1967), “Kolo na kolu” kod Balkanskih naroda: *Rad XIV Kongresa Saveza udruženja folklorista Jugoslavije u Prizrenu*.
- PROGRAM (1970, 1975), Susret nacija, pjesme i plesa: *Vjesnik*. Zagreb, 21. Srpnja. Program Megjunarodne smotre folklori Zagreb, 1966-1975. Zagreb.
- ROVINSKI, Pavel Apolonoviç (1998), *Etnografija Crne Gore I* (Përkthim nga rusishtja Vuk Miniç). Podgorica 47.
- SELIMI, Skënder (2003), *Folklori koreografik shqiptar*. Shtëpia e Librit Universitar. Tiranë, 2003, f. 85.
- SHUPO, Holta (2007), Jeta muzikore e qytetit shqiptar prej antikitetit të vonë deri në shekullin XVII: *Gjurmime albanologjike Folklor dhe Etnologji, 36-2006*. Prishtinë.
- SHOÇ, Vladimir (1984), *Starocrnogorske narodne igre*, Kulturno – prosvjetni sabor Hrvatske. Zagreb, 1984, f. 40.
- SOKOLI, Ramadan (1965), *Folklori muzikor shqiptar (Morfologjia)*. Instituti i Folklorit. Tiranë.
- VUJOVIÇ, Velimir (1933), *Crnogorsko oro u Crmnici*. Privrednik, Beograd.
- VUKMARKAJ, Preç (15 qershor 1881 – 1983), i biri i Macit, këngëtar dhe valltar i njohur, bujk, analfabet. Nga viti 1918 – 1959 vetëm dimrit, si

bari jetonte në Zalef, ndërsa familjarisht aty jetoi nga viti 1959 deri sa vdiq. Kur i regjistrova me magnetofon materialet folklorike dhe etnografike, edhe pse kishte shkelur të njëqindtat, ishte i fortë dhe mendjemprehtë. S'kena luojt si tash grô e trima, por me 'j anë (= një anë, me kuptimin: vend, hapësirë, dhomë, I. D.) grôtë. Janë ul pak kta t' poshtrit (= të poshtmit, që ndodhet poshtë, I. D) e ata kanë hypë mé (në majë) me kâmë n' krahë t' tynit (=tyre). Njani m'ej kamë t'ati tjetrit. Janë kapë atje njâni me tjetër, dorëpërdorë, nalt n'krahë.

Elle (= edhe) ata poshtë janë kapë kane (= kha, me kuptimin këtu, I. D.). Vetë i kanë majtë. Ë (= është, I. D.) sjell (vallja) rrumbullak. Ka filluo me kâmë t'djathtë. Pej t'shmangtës (= të majtës) ka e djathta. Mrapsht. Jo si shkon dielli. Rrotull, kadalkadalë. P. M. Vukmarkaj tregon: Aj n'kohën teme, aj zamanit tats (= tatës, babait, I. D.), axhën Lek Preçi, e kô(m) pa tye luojt. Kô kjenë burrë i fortë. Mô t'fortit rrinjin poshtë. Kta tjetër nelt.

..